



Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë, 15.03.2021

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 11.03.2021 të parashtruar nga Operatori Ekonomik "BRT" për aktivitetin: "Rregullimi i dyerve dhe dritareve në Institucionet Arsimore" dhe me numër të prokurimit: 616 -20-7534-521 nxjerr:

V E N D I M

Refuzohet kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik "BRT SHPK" e datës 11.03.2021 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Rregullimi i dyerve dhe dritareve në Institucionet Arsimore" dhe me numër të prokurimit: 616 -20-7534-521, kundër *Njoftimit për Vendimin e AK-se te datës 08.03.2021*, te publikuar në web-faqe të KRPP-së.

1. Vërtetohet *Njoftimi për Vendimin e Autoritetit Kontraktues të datës 08.03.2021*;
2. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik "BRT" me datë 11.03.2021 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Rregullimi i dyerve dhe dritareve në Institucionet Arsimore" dhe me numër të prokurimit: 616 -20-7534-521.

Autoriteti Kontraktues, me datë 15.03.2021 ka shqyrtuar kërkesën në fjalë dhe ka konstatuar si vijon:

-Pretendimet se Autoriteti Kontraktues nuk ka kërkuar sqarime nga ju lidhur me pozicionin numer 2 është i pa bazuar për faktin se nderhyrja në atë dokument është e palejuar. Edhe sikur të trajtohej si nderhyrje për të cilën mund të kërkohej sqarim, ju duhet të keni paqartësi se ka edhe një rregull tjetër që do t'iu përjashtonte për faktin se ndryshimi i çmimit do të ishte shumë më i lartë se sa korigjimi i lejuar aritmetik prej plus/minus 2%. Lidhur me këtë për korektesi ju sqarojme se totali i atij pozicioni pas korigjimit do të ishte 11,700.00 ndërsa në

oferten tuaj çmimi është 90,000.00 euro, pra mund ta kalkuloni vetë çfare do të ishte korigjimi aritmetik.

Bazuar në sqarimet e dhëna për pretendimet tuaja u vendos si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së.

Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit të këtij vendimi.

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit

